

K Ë R K E S Ë

Kërkuese: Merzai Bregasi, e bija e Isufit, datëlindja 1963, lindur në Topojan - Përmet, banuese në Lapan-Skrapar, e martuar me tre fëmijë.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit Hasan Bregasi, në bazë të nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe të nenit 15 të Kodit Civil.

Hasan Bregasi, në prill 1994 ka shkuar në emigracion klandestin në Greqi së bashku me djalë e hallës së tij, shtetasin Ilirjan Çuedari. Pas disa muajsh, familja ka marrë njoftim nëpërmjet Ilirjan Çuedarit se në banesën ku jetonte Hasani së bashku me Ilirjan Çuedarin, Hektor Dashin dhe një djalë tjetër nga fshati Zaberzan, një natë shkoi policia greke dhe të katër u shpërndan në drejtime të ndryshme për të shpëtuar. Pasi është larguar policia, ata janë kthyer në banesë, por Hasani nuk u kthye. Të tre personat pretendojnë se kur qëndronin të fshehur, kanë dëgjuar një rënkim dhe një derë makine që është mbyllur me forcë.

Më pas ata janë kthyer në Shqipëri dhe kanë sjellë në shtëpi kursime nga puna e Hasanit dhe sendet e tij personale. Që nga ky moment nuk kemi marrë asnjë njoftim nga Hasani. Në këto rrethana kërkoj deklarinimin si të zhdukur të bashkëshortit tim Hasan Bregasi. Gjithashtu, kërkoj që të emërohem kujdestare e pasurisë së tij.

KËRKUESE
Merzai Bregasi

